



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**

**RREGULLORE MBI PROCEDURËN PËR APLIKIM, MIRATIM DHE ZBATIM TË
PROJEKTEVE TË FINANCUARA NGA TË ARDHURAT E
UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI"**

Miratuar me vendimin e Senatit Akademik nr. 69, datë 22.2.2024

**KRYETARI I SENATIT
REKTORI
Prof.dr. Dhimitri Bello**

TABELA E PËRMBAJTJES:

Neni 1: Hyrje.....	3
Neni 2: Baza ligjore dhe objekti	3
Neni 3: Qëllimi dhe objektivat.....	3
Neni 4: Kriteret e pranueshmërisë	3
Neni 5: Shuma monetare për projektin	4
Neni 6: Afatet e aplikimit	5
Neni 7: Mënyra e aplikimit	5
Neni 8: Fushat e projektit përfundimtar.....	7
Neni 9: Dispozitat të fundit.....	7
FORMATI I: Forma e aplikimit për projekte të kërkimit shkencor financiar nga të ardhurat e Universitetit “Fan S. Noli”	8
FORMATI II: Formati i raportimit periodik.....	
FORMATI III: Raporti përfundimtar i projektit.....	
FORMATI IV: Kriteret për vlerësimin e projektpropozimeve.....	

Neni 1

Hyrje

Projektet e financuara nga Universiteti "Fan S. Noli" kanë si qëllim iniciativa të ndryshme për përmirësimin e nevojave të institucionit, kapaciteteve të veta dhe rolit të tij në të mirë të zhvillimit rajonal e kombëtar. Këto grande përfshijnë thirrje specifike të publikuar/a që ofron/jnë detaje në lidhje me një fushë të përgjithshme me interes, duke përcaktuar afatet kohore për rishikim, aprovim dhe marrjen e vendimeve përfundimtare për shpenzimin e grantit. Përfituesit e projektit kanë përgjegjësinë për hartimin, zbatimin dhe kryerjen e iniciativës së kërkuar.

Neni 2

Baza ligjore dhe objekti

Kjo rregullore detajon procedurat e rregullat e aplikimit dhe zbatimit të projektpropozimeve të financuara nga të ardhurat e Universitetit "Fan S. Noli" dhe nga Buxheti i Shtetit dhe bazohet në nenet 93, 94 dhe 95 të Ligjit Nr. 80/2015 *"Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"*; Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 *"Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë"*, Udhëzimin nr. 19, dt. 31.05.2011 *"Për detajimin e buxhetit të institucioneve publike të arsimit të lartë në programin "Për kërkim fundamental dhe ekselencë"* si dhe Objektivit 1 *"Rritja e veprimtarive hulumtuese në njësitë kryesore dhe standardizimi i saj me parimet e etikës së kërkimit"* të Planit Strategjik të Zhvillimit 2022-2027.

Neni 3

Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi kryesor është mbështetja e personelit akademik me kohë të plotë në përmbushjen e aktivitetit kërkimor sipas prioriteve kërkimore të Universitetit "Fan S. Noli", nëpërmjet hulumtimit në fushat specifike, nxjerrjen e të dhënave shkencore të besueshme, dhe vënien e tyre në dispozicion të palëve të interesit në rajon dhe më gjerë.

Neni 4

Kriteret e pranueshmërisë:

Kriteret e pranueshmërisë janë:

1. Përmbajtja dhe objektivat e projektit duhet të jenë në përputhje me misionin dhe fushat e veprimtarinë kërkimore të Universitetit "Fan S. Noli", Strategjinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Planin Strategjik Zhvillimit 2022-2027 të Universitetit "Fan S,

Noli”; si dhe fushave kërkimore specifike të përcaktuara nga njësitë bazë.

2. Koordinator i projektit duhet të jetë specialist i fushës për të cilën hartohet projekti. Grupi i punës përfshin së paku 4 (katër) staf akademik me kohë të plotë/administrativ/personel ndihmësakademik/studentë; në përbërje mund të ftohen edhe përfaqësues të palëve të interesit, apo institucioneve partnere.
3. Inkurajohen projekte që mbështesin nisma ndërdisiplinore dhe që mund të sigurojnë perspektiva për bashkëpunim në të ardhmen për projekte me ndikim më të gjerë kombëtar dhe ndërkombëtar.

Neni 5

Buxheti

1. Shuma monetare maksimale që mund të ofrohet në kuadër të secilit projekt varet nga buxheti i miratuar për zërin përkatës në buxhetin e institucionit.
2. Ky buxhet mund të përdoret për:
 - a) **Honorare** për pagesat e stafit të angazhuar në projekt. Ky zë shpenzimi nuk duhet të kalojë 50% të buxhetit të parashikuar në projekt.
 - b) **Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara** që i shërbejnë drejtpërdrejt realizimit të projektit kërkimor: pajisje dhe instrumente laboratorike, pajisje teknologjike, krijim fondi biblioteke, blerje dhe instalim rrjetit kompjuterik, makineri, pajisje elektronike. Ky zë shpenzimi nuk duhet të kalojë 25% të buxhetit të parashikuar në projekt.
 - c) **Shpenzimet për udhëtim dhe dieta:** shpenzimet e udhëtimit dhe dietat e anëtarëve të projektit, si për marrje provash, kryerje matjesh, intervista/anketime në terren dhe veprimtari të tjera të ngjashme me to. Për shpenzimet e kryera nga punonjësit kur largohen jashtë qendrës së punës, shpenzimet parashikohen sipas kuotave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
 - d) **Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca, seminare, kongrese, simpoziume, shkëmbim informacioni e të tjera të ngjashme me to dhe publikime profesionale** (vetën në rastet kur stafi ka kontribut shkencor si autor i parë dhe i dytë dhe kontributi është pjesë e projektit kërkimor).

- e) **Shpenzime përfaqësimi dhe transferime korrente me jashtë:** shpenzime për organizimin e aktiviteteve shkencore dhe diskutimit të të dhënave, kuotave të anëtarësimit që jepen për përfaqësimet në organizata të ndryshme shkencore jashtë vendit me statusin e anëtarit ose të vëzhguesit.

3. Detajime:

- i. Në rast se projektpropozimi përfshin edhe fonde nga burime të tjera financimi, këto parashikohen/detajohen në marrëveshjen mes palëve që shoqëron projektpropozimin.
- ii. Përqindjet respektive të zërave buxhetorë 2c, 2d, 2e llogariten sipas specifikave të projektpropozimit deri në masën 25% të buxhetit të parashikuar në projekt.
- iii. Çmimet për shpenzimet e parashikuara në pikat 2b parashikohen me TVSH.
- iv. Dokumentet e aplikimit për mbulimin e shpenzimeve në pikat 2c, 2d dhe 2e duhen dorëzuar të paktën 15 ditë para organizimit të aktivitetit/shpenzimit të parashikuar.
- v. Specifikimet teknike për aktivet e qëndrueshme të trupëzuara në pikën 2b paraqiten të detajuara në projektpropozim.
- vi. Shpenzime që nuk lejohen në buxhet janë: mirembajtja infrastrukturore, kosto ndërtimi, tarifa bankare, marrje me qira e pajisjeve kapitale, ambienteve, koktej, etj.
- vii. Pajisjet, materialet, literatura e blerë për projektin përmes këtij financimi mbetet në pronësi të Universitetit “Fan S. Noli” pas përfundimit të zbatimit të projektit.
- viii. Publikimet apo produkte të tjera që rezultojnë nga kërkimi duhet të deklarohen se janë financuar nga Universiteti “Fan S. Noli”.

Neni 6 **Afatet e aplikimit**

1. Thirrja për projekt-propozime shpallet në muajin shtator.
2. Data përfundimtare për dorëzimin e aplikimit është një muaj pas shpalljes së thirrjes.
3. Afati për informimin e fituesve është 20 (njëzet) ditë pas dorëzimit të aplikimit;
4. Afati i zbatimit të projektit është deri në 7 muaj pas shpalljes së rezultateve.

Neni 7 **Mënyra e aplikimit**

1. Hapja e thirrjes dhe aplikimi:

- a) Thirrja për aplikim miratohet paraprakisht nga Bordi i Administrimit, me propozim të Rektoratit të Universitetit.
- b) Pas shpalljes së thirrjes për aplikim, të gjithë të interesuarit janë të detyruar të dorëzojnë pranë Dekanit të Fakultetit një projektpropozimin, ku do të prezantohet titulli i studimit, qëllimi i studimit, metodologjia, grupi i punës (koordinatori dhe stafi mbështetës), buxheti i kërkuar për çdo zë, etj.

- c) Në këtë fazë përcaktohet procesi se si do të zbatohet projekti nëse shpallet fitues. Po ashtu në këtë fazë do prezantohet planifikimi i detajuar për realizimin e detyrave dhe buxhetit të projektit (Formati I).

2. Në dosjen e aplikimit përfshihet:

- a) Kërkesa e protokolluar e drejtuesit të projektit, drejtuar Rektorit të Universitetit “Fan S. Noli”.
- b) Miratimi i Dekanit të njësisë kryesore nga vjen projekt propozimi.
- c) Forma e aplikimit për projekte të kërkimit shkencor të financuara nga të ardhurat e Universitetit (Formati I).
- d) CV-ja e drejtuesit të projektit.
- e) Marrëveshje nënshkruar me palë interesi të përfshira në projekt (nëse), ku specifikohet roli, format e bashkëpunimit dhe/ose financimit të parashikuara në projekt propozim.

3. Miratimi i projektpropozimit:

- a) Në bazë të aplikimeve, brenda 10 ditësh pas mbylljes së aplikimeve, Rektori ngre komisionin adhoc për vlerësimin e projektpropozimeve.
- b) Komisioni kryen vlerësimin bazuar mbi kriteret e përgjithshme*:
 - i. Domethënia shkencore dhe qartësia e projektit (40 pikë)
 - ii. Menaxhimi buxhetor i zërave të projektit (20 pikë)
 - iii. Qëndrueshmëria e projektit (15 pikë)
 - iv. Ekspertiza e grupit të punës në lidhje me fushën e përzgjedhur (15 pikë)
 - v. Partneriteti (10 pikë)
- * Projekti konsiderohet i vlefshëm për mbështetje për financim, vetëm nëse merr të paktën 70 pikë nga vlerësimi i Komisionit Vlerësues.
- * Detajimi i kriterëve të vlerësimit dhe pikëzimi përkatës pasqyrohen në Formatin II.
- * Komisioni mund t’u shtojë këtyre kriterëve edhe kriterë specifike, në varësi të përmbajtjes dhe formatit të thirrjes.
- c) Vendimi i Komisionit i përcillet Senatit Akademik dhe pas miratimit nga ky organ, i përcillet drejtuesit të projektit, i cili vijon me aplikimin e projektit sipas aktiviteteve dhe kohëzgjatjes së miratuar.

4. Zbatimi:

- a) Gjatë kësaj faze, fituesit e projektit janë të detyruar të zbatojnë projektin e fituar duke

ndjekur të gjitha rregullat e etikës së hulumtimit shkencor.

- b) Në këtë fazë grupi i punës është i detyruar të zbatojë me kujdes të gjitha aktivitetet e parashikuara në projekt me qëllim arritjen e objektivave. Plani i zbatimit përbëhet nga të gjitha aktivitetet e parashikuara dhe monitorohet nga Drejtoria e Projekteve dhe Kërkimit Shkencor
- c) Kjo e fundit koordinon gjithë komunikimin mes drejtuesit të projektit dhe njësive të tjera administrative dhe akademike në institucion.

5. Përfundimi dhe dorëzimi:

- a) Raportimet mbi ecurinë e projektit hartohen sipas Formatit III dhe IV dhe dorëzohen në mes dhe në fund të zbatimit të projektit.
- b) Grupi/et kërkimor/e janë të detyruar të dorëzojnë raportin përfundimtar të realizimit të projektit jo më vonë se 2 (dy) javë pas përfundimit të projektit. Raporti përfundimtar dorëzohet pranë Drejtorisë së Projekteve dhe Kërkimit Shkencor, e cila e përcjell pranë Komisionit të Vlerësimit. Në rastet kur ky Komision nuk e miraton raportin, grupi i punës është i detyruar të bëjë korrigjimet dhe rregullimet sipas propozimeve. Në rastin se këto propozime nuk zbatohen, projekti quhet i dështuar dhe grupi i punës është i detyruar të kthejë të gjithë shumën e shpenzuar në kuadër të projektit.
- c) Në rastet kur raporti përfundimtar miratohet, ky dokument i dorëzohet Drejtorisë së Projekteve dhe Kërkimit Shkencor, e cila në bashkëpunim me grupin e punës parashikon zbatimin e përhapjes së rezultateve. Në këtë fazë duhet të prezantohen qartë rezultatet e projektit, arritjet, mos-arritjet dhe arsyet si dhe shpenzimet e bëra, sipas zërave të mëposhtëm: qëllimi dhe objektivat, metodologjia e projektit, ndryshimet e bëra në objektivat origjinalë (nëse ka të tilla), zbatimi i projektit, rezultate, vlerësimi i rezultateve, rekomandime, përfitimet e institucionit, promovimi i rezultateve, menaxhimi i rreziqeve të shfaqura gjatë aplikimit, shpenzimet e buxhetit.

Neni 8 Dispozita të fundit

1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Bordi i Administrimit dhe Senati Akademik dhe zbatohet duke filluar nga viti akademik 2023-2024.
2. Thirrja për projektpropozime për vitin 2024 bën përjashtim nga afatet e përcaktuara në këtë rregullore. Për këtë vit akademik thirrja shpallet në shkurt 2024.
3. Rregullorja “Procedura për aplikim, miratim dhe zbatim të projekteve të financuara nga të ardhurat e institucionit dhe nga buxheti i shtetit”, miratuar me vendimin e Senatit Akademik nr. 299, datë 07.07.2022, shfuqizohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË

FORMATI I

FORMA E APLIKIMIT PËR PROJEKTE TË KËRKIMIT SHKENCOR
FINANCUAR NGA TË ARDHURAT E UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI"

Në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 *"Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"*, Neni 93, Neni 94 dhe Neni 95, Udhëzimit Nr. 29, datë 10.09.2018 *"Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë"*, Udhëzimit nr. 19, dt. 31.05.2011 *"Për detajimin e buxhetit të institucioneve publike të arsimit të lartë në programin "Për kërkim fundamental dhe ekselencë"*, VKM-së Nr.329, datë 12.4.2017 *"Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik"*, pika 18, si dhe Objektivit 1 *"Rritja e veprimtarive hulumtuese në njësitë kryesore dhe standardizimi i saj me parimet e etikës së kërkimit"* të Planit Strategjik të Zhvillimit 2022-2027, si dhe *Rregullores për procedurën për aplikim, miratim dhe zbatim të projekteve të financuara nga të ardhurat e Universitetit "Fan S. Noli"* Ju përcjell kërkesën për aplikim në projektin me titull _____.

Ky projekt-propozim ka si qëllim kryesor _____.

1. Të dhënat e njësisë

Njësia aplikuese	
Institucion partner (nëse ka)	
Titulli i Projektit	
Fusha ku aplikohet*	
Drejtues i projektit	
Kohëzgjatja e projektit	
Buxheti i kërkuar nga Universiteti "Fan S. Noli"	
Buxheti i mbuluar nga burime të tjera (Nëse ka, ju lutem specifikoni burimet)	
Buxheti total i projektit	

2. Të dhënat e personave pjesëmarrës në këtë Projekt

Emër, mbiemër	Posti që mban	Grada shkencore	Kontakte: Celular E-mail	Aktivitet kërkimor i lidhur me fushën e projektpropozimit
1.				
2.				
3.				
4.				

3. Të dhëna të përgjithshme mbi projektin*

(*Jepni një përmbledhje të projekt propozimit, për t'u kuptuar edhe nga një audiencë jo-akademike. Shpjegoni kontekstin e kërkimit, qëllimet dhe nevojat për ndërhyrje, risqet dhe grupet e synuara, duke përfshirë edhe përfitimet e mundshme në të ardhmen. Në rast të financimit të projekt idesë tuaj kjo pjesë do të publikohet në faqen e internetit të Universitetit. Deri në 3000 karaktere).

Përshkrimi i gjendjes aktuale	Përshkruani historikun e problemit duke theksuar hipotezat që dëshironi të adresoni. Përcaktoni qartë qëllimet afatshkurtra dhe afatgjata të kërkimit. Specifikoni lidhjen e propozimit me objektivat specifike të fushave të veprimit të propozuara nga Njësia Bazë apo Njësia Kryesore. Përshkruani karakterin inovativ dhe ndër disiplinor të projekt propozimit.
Nevojat për ndërhyrje (të detajuar në pika)	Përshkruani qartë kontekstin specifik mbi të cilin është duke u zhvilluar projekti.
Rezultatet e pritshme (në përputhje me kriteret e kërkimit shkencor të aplikuar, rritjen e shërbimeve të ofruara dhe promovimin e kërkimit në rrjet ndërinstitucional)	Përshkruani rezultatet e parashikuara shkencore, përfitimet për grupet e synuara për hulumtimin e propozuar brenda institucionit, në nivel lokal apo kombëtar. Detajoni analizën e kontekstit nëpërmjet metodës SWOT (pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet që lidhen planifikimin e projektit).

4. Argumentimi shkencor i Projektit (max. 3000 fjalë).

4.1 Identifikimi i nevojave dhe rëndësia e realizimit të tij

4.2 Lloji i infrastrukturës kërkimore të nevojshme për realizimin e projektit

4.3 Kontributet specifike që sjell projekti në kërkimin e aplikuar në rajon

5. Qëllimi dhe objektivat e projektit (max. 600 fjalë)

5.1 Qëllimi

5.2 Objektivat specifike të projektit

6. Aktivitetet që priten të realizohen me këtë instrafstrukturë të kërkimit shkencor (të lidhura me objektivat) (max. 1000 fjalë)

7. Metodologjia për realizimin e objektivave (max. 1000 fjalë)

8. Rezultatet e pritshme të projektit të paraqitur (të lidhura me objektivat dhe aktivitetet) (max. 500 fjalë)

8.1 Si mendohet t'iu bëhen të njohura rezultatet e projektit përdoruesve të mundshëm të tyre?

9. Përfituesit e projektit

Analiza e grupeve të synuara dhe e palëve të interesit nga projekti.

(Identifikoni dhe rendisni përfituesit dhe nevojat e tyre. Shpjegoni se si objektivat specifike të projektit dhe aktivitetet e parashikuara në projekt do të adresojnë nevojat e përfituesve. Përkthyeri se si do të arrihen dhe përfshihen grupet e synuara gjatë gjithë jetës së projektit dhe se si grupet e synuara do të përfitojnë nga ky projekt brenda institucionit, në nivel lokal apo kombëtar.)

9.1 Numri i Përfituesve direktë.

9.2 Numri i Përfituesve indirektë (industria, biznesi, IAL të tjera, institucione, etj)

10. Qëndrueshmëria e rezultateve (max. 500 fjalë)

11. Plani i punës

Kalendari i aktiviteteve (përkthyeri aktivitetet që lidhen me zbatimin e projektit)

Aktiviteti/Muaji	1	2	3	4	5	6	7

12. Struktura analitike e projektit

Projekt-struktura	Indikatorët e performancës	Mjetet e verifikimit	Supozimet e rrezikut
Qëllimi			
Objektivat			
Rezultatet			
Aktivitetet			

13. BUXHETI I PROJEKTIT

13.1. Buxheti i propozuar

Zëri në buxhet	Tipi	Sasia	Njësia	Shuma	Përshkrimi i detuajuar
Honorare për pagesat e stafit të përfshirë në projekt ¹	-				
Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme ²					
Shpenzime për udhëtime e dieta ³					
Shpenzime për pjesëmarrje në aktivitete shkencore/publikime ⁴					
Shpenzime përfaqësimi dhe transferime korrente me jashtë ⁵					

¹ Honorare për pagesat e stafit të angazhuar në projekt. Ky zë shpenzimi nuk duhet të kalojë 50% të buxhetit të parashikuar në projekt.

² Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara që i shërbejnë drejtpërdrejt realizimit të projektit kërkimor: pajisje dhe instrumente laboratorike, pajisje teknologjike, krijim fondi biblioteke, blerje dhe instalim rrjetit kompjuterik, makineri, pajisje elektronike. Ky zë shpenzimi nuk duhet të kalojë 25% të buxhetit të parashikuar në projekt.

³ Shpenzimet për udhëtim dhe dieta: shpenzimet e udhëtimit dhe dietat e anëtarëve të projektit, si për marrje provash, kryerje matjesh, intervista/anketime në terren dhe veprimtari të tjera të ngjashme me to. Për shpenzimet e kryera nga punonjësit kur largohen jashtë qendrës së punës, shpenzimet parashikohen sipas kuotave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

⁴ Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca, seminare, kongrese, simpoziume, shkëmbim informacioni e të tjera të ngjashme me to dhe publikime profesionale (vetëm në rastet kur stafi ka kontribut shkencor si autor i parë dhe i dytë dhe kontributi është pjesë e projektit kërkimor).

⁵ **Shpenzime përfaqësimi dhe transferime korrente me jashtë:** shpenzime për organizimin e aktiviteteve shkencore dhe diskutimit të të dhënave, kuotave të anëtarësimit që jepen për përfaqësimet në organizata të ndryshme shkenore jashtë vendit me statusin e anëtarit ose të vëzhguesit.

**Detajimet e mëtejshme të sa më sipër paraqiten në Rregulloren për procedurën për aplikim, miratim dhe zbatim të projekteve të fiancuara nga të ardhurat e Universitetit “Fan S. Noli”*

Detyra	Titulli, Emri, Mbiemri	Datë	Nënshkrimi
Drejtuksi i Projektit			
Dekani i Fakultetit			



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË

FORMATI II

KRITERET PËR VLERËSIMIN E PROJEKTPROPOZIMEVE

Kriteri	Fusha e vlerësimit	Vlerësimi
<i>Kriteri I: Domethënia shkencore dhe qartësia e projektit</i>	Vlera e temës së trajtuar- qartësia e objektivave	8 pikë
	Origjinaliteti i temës së zgjedhur/ Karakteri inovativ	8 pikë
	Metodologjia e planifikuar (në përputhje me objektivat)	8 pikë
	Prezantimi i aktiviteteve (në përputhje me objektivat dhe kohëzgjatjen e parashikuar në thirrje)	8 pikë
	Përshkrimi i kushteve të zbatimit të aktiviteteve	8 pikë
		40 pikë
<i>Kriteri II: Ekspertiza e grupit të punës në lidhje me fushën e përzgjedhur</i>	Ekspertiza shkencore e koordinatorit	7 pikë
	Ekspertiza shkencore e grupit të punës	8 pikë
		15 pikë
<i>Kriteri III: Partneriteti</i>	Dimensioni ndërdisiplinor	5 pikë
	Lidhja e projektit me palët e interesit jashtë UNIKO	5 pikë
		10 pikë
<i>Kriteri IV: Qëndrueshmëria e projektit</i>	Ngritja e strukturave të qëndrueshme që sigurojnë vijueshmërinë e veprimtarisë edhe pas përfundimit të projektit	10 pikë
	Fuqizimi i studiuesve të rinj dhe/ose përfshirja e studentëve si palë interesi	5 pikë
		15 pikë
<i>Kriteri V: Buxheti</i>	Menaxhimi buxhetor i zërave të aktiviteteve	20 pikë
		Total: 100 pikë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË

FORMATI III

FORMATI I RAPORTIMIT PERIODIK

TITULLI I PROJEKTIT

Nr.	Të dhëna	Informacion
1.	Miratuar në thirrjen	
2.	Periudha e fillimit	
3.	Periudha e përfundimit	
5.	Financimi total	
6.	Vlera e financimeve të përfituara – faza I	
7.	Fakulteti	
8.	Departamenti	
9.	Drejtues projekti	
10.	Grupi i punës	
11.	Periudha e raportimit	

PASQYRA PËRMBLEDHËSE

1. Përshkrim i projektit dhe komponentët e projektit

2. Detajimi i projektit në nivel objektiv dhe produkti

2.1 Objektivat specifike të projektit

2.2 Produktet për çdo objektiv

2.3 Impakti i produktit në departament/ fakultet/ institucion

3. Ecuria e projektit nga fillimi deri në periudhën e raportimit I

Aktivitetet (Fillim/-----)

Aktivitet	Raportimi I	Raportimit II

Staf/studentë/ palë interesi të përfshirë

.....

4. Problematikat e hasura

.....

5. Tabela e Disbursimeve/ Shpenzimeve

Fonde te angazhuara (kosto totale e projektit)	Disbursimi Raportim I (i detajuar sipas zërave në projekt)	Disbursimi Raportim II (i detajuar sipas zërave në projekt)

Drejtuesi i Projektit

Data:_____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I PROJEKTIT

FORMATI IV

1. Përmbledhje e Rezultateve dhe të projektit (500 fjalë);
2. Justifikimi i ndryshimeve të realizuara (500 fjalë);

Qëllimi:
Objektivi 1:
Realizuar \ Jo i realizuar \ I ndryshuar
Detaje mbi objektivin 1 dhe rezultatin

Qëllimi:
Objektivi 2:
Realizuar \ Jo i realizuar \ I ndryshuar
Detaje mbi objektivin 2 dhe rezultatin

Buxheti

Zëri	Buxheti i parashikuar	Buxheti i realizuar	Detaje
Stafi			
Udhëtime/dieta			
Seminare/konferenca			
Pajisje			
Aktivitete			
Publikime			
Etj.			

Drejtuesi i projektit:

